



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine*  
*Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

---

**RREGULLORE (MINT) Nr. 01/2023 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (MTI)  
NR. 01/2018 PËR ETIKETIMIN DHE SHËNJIMIN E PRODUKTEVE TË TEKSTILIT**



**Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L -041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, nenit 11 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, Shtojca 12 e Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenin 38, paragrafi 6 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 15, 12.09.2011),

Miraton:

**RREGULLORE (MINT) Nr. 01/2023 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (MTI) NR. 01/2018 PËR ETIKETIMIN DHE SHËNJIMIN E PRODUKTEVE TË TEKSTILIT**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (MTI) Nr. 01/2018 për etiketimin dhe shënjimin e produkteve të tekstilit.



2. Kjo Rregullore është në përputhje me Rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2018/122 e datës 20 tetor 2017 për ndryshimin e Aneksëve I, II, VI, VIII. dhe IX të Rregullores (BE) nr. 1007/2011 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimin dhe shënimin përkatës të përbërjes së lëndës së parë të produkteve tekstile.

### **Neni 2**

1. Neni 10 paragrafi 3 i Rregullores (MTI) Nr. 01/2018 për etiketimin dhe shënjimin e produkteve të tekstilit ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Në rastin e produkteve të përcaktuara në nenin 9 paragrafin 3 të kësaj Rregullore, përqindjet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni do të llogariten veçmas për peshën e fijeve të bazës dhe veçmas për ato të indit.

### **Neni 3**

Me këtë Rregullore ndryshohen dhe plotësohen Shtojcat I, II, VI, VIII dhe IX të Rregullores (MTI) Nr. 01/2018 për etiketimin dhe shënjimin e produkteve të tekstilit.

### **Neni 4** **Hyrja në fuqi**

Ky Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

**Rozeta Hajdari**

---

**Ministre e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**  
**Datë: 03.08.2023**



## SHTOJCA I

Shtojcat I e Rregullores (MTI) Nr. 01/2018 për etiketimin dhe shënjimimin e produkteve të tekstilit ndryshohen dhe plotësohen si në vijim:

**1. Në Shtojcën I, tabela numër 2, shtohet numri 49 dhe 50 me tekstin si në vijim:**

49	Polipropilen/poliamide bikomponent	Fibra dykomponente e përbërë nga 10% dhe 25% masë e fibrileve poliamide të ngulitura në matricën e polipropilenit
50	Poliakrilat	Fibra e formuar e makromolekulave të ndërlidhura që kanë më shumë se 35 % (nga masa) e grupeve të akrilatit AC (acid, kripëra të lehta metalike ose estere) dhe më pak se 10 % (nga masa) e grupeve akrilonitrile në zinxhir dhe deri në 15 % (nga masa) e azotit në lidhjet e kryqëzuara;



## SHTOJCA II

### **Në Shtojcën II, pikat e mëposhtme ndryshohen si më poshtë:**

Ndryshohen dhe plotësohen pikat (2), (3), (5), (7) dhe shtohet pika (8), me tekstin si në vijim:

(2) Përkufizimi i propozuar i fibrës së tekstilit:

Përkufizimi i propozuar duhet të përshkruaj përbërjen e fibrave. Karakteristikat e përcaktuara në përkufizimin e fibrës së re të tekstilit, siç është elasticiteti, do të jenë të verifikueshme përmes metodave standarde testuese, që do të pajisen me dokumentacionin teknik së bashku me rezultatet e ekzaminimit të analizave.

(3) Identifikimi i fibrës së tekstilit: formula kimike, dallimet nga fijet ekzistuese të tekstilit, spektri FTIR së bashku me të dhëna të detajuara, kur është e nevojshme, siç janë pika e shkrirjes, densiteti, indeksi i thyerjes dhe reagimi ndaj djegies.

(5) Metodatat e propozuara të identifikimit dhe kuantifikimit, përfshirë të dhënat e ekzaminimit:

Aplikuesi do të vlerësojë mundësinë e përdorimit të metodave të përcaktuara në Shtojcën VIII të Rregullores Nr.01/2018 për Etiketimin dhe Shënjimin e Produkteve Tekstile ose standardet e harmonizuara të specifikuara në atë Shtojcë të përdorura për testimin e përzierjeve më të zakonshme komerciale të fibrave të reja tekstile me fibra të tjera tekstile dhe do të propozojë të paktën një nga ato metoda.

Për ato metoda testuese ose standarde të harmonizuara ku fibra tekstile mund të konsiderohet si një përbërës i patretshëm, aplikuesi vlerëson faktorët e korigjimit të masës “d” që korrespondon me faktorin korigjues për humbjen e masës së përbërësit të patretshëm në reagjent gjatë analizës, dhe i cili përdoret në llogaritjen e masës së fibrave të reja të tekstilit.

Nëse metodatat e përcaktuara në këtë Rregullore nuk janë të përshtatshme, aplikuesi ofron shpjegimet e duhura dhe propozon një ose më shumë metoda të reja. Metoda apo metodatat e reja të propozuara përshkruajnë fushën e aplikimit (përfshirë: përzierjet e fibrave), parimet



(procesin kimik dhe hapat), pajisjet dhe reagjentët, procedurat e testimit, llogaritjen dhe shprehjen e rezultateve (duke përfshirë vlerën e faktorit “d”, si dhe saktësinë (besueshmëria në vlerat kufitare të rezultateve) .

Aplikacioni përmban të gjitha të dhënat e ekzaminimit, veçanërisht në lidhje me karakteristikat e fibrave, identifikimin dhe metodat e propozuara të kuantifikimit. Të dhënat për saktësinë, qëndrueshmërinë dhe përsëritjen e metodave do të pajisen me dokumentacion.

(7) Informacion shtesë për të mbështetur aplikacionin mbi procesin e prodhimit dhe rëndësinë e fibrës së re tekstile për konsumatorin:

Dokumentacioni teknik, të paktën, duhet të përmbajë informacione mbi numrin e prodhuesve, vendndodhjen e objekteve të prodhimit dhe disponueshmërinë e fibrës së re në treg ose produkteve të prodhuara nga ato fibra të reja.

(8) Disponueshmëria e mostrave:

Prodhuesi ose cilido person që vepron në emër të prodhuesit do të sigurojë mostra përfaqësuese të fibrave të reja të tekstilit të pastër dhe përzierjet përkatëse të fibrave të tekstilit të nevojshme për verifikimin e saktësisë, qëndrueshmërisë dhe përsëritjes së metodave të propozuara të identifikimit dhe kuantifikimit. Inspektorati kompetent për mbikëqyrjen e tregut mund të kërkojë mostra shtesë të përzierjeve përkatëse të fibrave nga prodhuesi ose personi që vepron në emër të prodhuesit.



## **SHTOJCA VI**

**Në Shtojcën VI, pika 18 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:**

18. Fijet për qepje, arnim dhe qëndisje të cilat ofrohen për shitje me pakicë.



## SHTOJCA VIII

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2 Në tabelën përmbledhëse të pikës IV, ndryshohet rreshti 11 dhe shtohet rreshti i mëposhtëm për metodën nr. 17, me tekstin si më poshtë:

Metoda	Fusha e zbatimit (*)		Reagjenti/Përshkrimi
	Komponent i tretshëm	Komponent i patretshëm	
11	Mëndafsh, poliamid ose najlon	Fibra të tjera të caktuara	Acid sulfurik, 75 % m/m
17	Poliester	Fibra të tjera të caktuara	Acidi trikloroacetik dhe kloroformi

(\*) Lista e detajuar e fibrave sipas secilës metode

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.1 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Leshi (1), qimet e kafshëve (2 dhe 3), mëndafshi (4), pambuku (5), fijet e lirit (7) kërpi i vërtetë (8), jutë (9), abakë (10), alfa (11), kokos/Coir (12), fshesë (13), rami, (14), sizal (15), fibra kupro (21), fibra modale (22), fibra proteinike (23), viskozë (25), akrilik (26), poliamid ose najlon (30), fibra poliester (35), polipropilen (37), elastomultiester (45), elastolefinë (46), fibra melaminë (47), fibra polipropileni/poliamide me dy komponentë (49) dhe poliakrilat (50).





Në asnjë rrethanë nuk është e zbatueshme metoda për fibrat acetate të cilat janë deacetiluar në sipërfaqe.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.1, Pika 5 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

#### 5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet llogariten siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e “d” është 1,00, përveç melaminës dhe poliakrilatit, për të cilën “d” është 1,01.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.2 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Pambuku (5), fibra kupro (21), fibra modale (22), viskozë (25), akrilik (26), fibra klorure (27), poliamid ose najlon (30), poliester (35), polipropilen (37), elastan (43), fibër qelqi (44), elastomultiester (45), elastolefinë (46) dhe melaminë (47), fibra polipropileni/poliamide dy komponent (49).

Nëse ka fibra të tjera proteinike, metoda jep përmbajtjen e tyre totale, por jo sasinë e tyre individuale.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.3 (Titulli) ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

#### VISKOZA, KUPRO OSE DISA LLOJE TË MODALEVE DHE DISA FIBRA TË TJERA

(Metodë me acid formik dhe klorur zinku)

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Pambuku (5), polipropilen (37), elastoolefinë (46) dhe melaminë (47).



Nëse konstatohet se ekziston një fibër modale, do të kryhet një test paraprak për të parë nëse është e tretshme në reagjent.

Kjo metodë nuk zbatohet për përzierjet në të cilat pambuku ka pësuar degradim të konsiderueshëm kimik dhe as për përzierjet në të cilat viskoza dhe fibra e bakrit konsiderohen se nuk janë plotësisht të tretshme për shkak të pranisë së disa llojeve të ngjyrave ose agjentëve për finalizim që nuk mund të hiqen plotësisht.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.3, Pika 5 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

#### 5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet llogariten siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e “d” është 1,00, përveç pambukut, për të cilën “d” është 1,02 dhe për melanine për të cilën “d” është 1,01.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.5 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Triacetate (24), polipropileni (37), elastolfina (46), melamina (47), polipropileni/poliamide dykomponent (49) dhe poliakrilate (50).

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.6 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:



2. Leshi (1), qimet e kafshëve (2 dhe 3), mëndafshi (4), pambuku (5), fibra bakri (21), fibra modale (22), viskozë (25), akrilik (26), poliamid ose najlon (30), poliestër (35), polipropilen (37), fibër qelqi (44), elastomultiester (45), elastolefinë (46), melaminë (47), bikomponent polipropilen/poliamid (49) dhe poliakrilat (50).

Shënim:

Fijet triacetate që u përpunuan përfundimisht kanë rezultuar në hidrolizë të pjesshme, nuk janë më plotësisht të tretshme në reagjent. Në këto raste, metoda nuk është e zbatueshme.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.7 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. poliestër (35), polipropilen (37), elastomultiester (45), elastolefinë (46), dhe bikomponent polipropilen/poliamid (49).

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.7, Pika 5 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

#### 5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet llogariten siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e “d” është 1.00 me përjashtim të fibrës bikomponent polipropilen/poliamide për të cilën është “d” = 1.01.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.8 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:



2. Leshi (1), qimet e kafshëve (2 dhe 3), mëndafshi (4), pambuku (5), fibra bakri (21), fibra modale (22), viskoza (25), poliamide ose najlon (30), poliesteri (35), polipropileni (37), elastomultiester (45), elastolefina (46), melamina (47), bikomponenti polipropilen/poliamid (49) dhe poliakrilati (50).

Kjo metodë vlen në mënyrë të barabartë për akrilik dhe disa fibra modakrilik të trajtuara me ngjyra komplekse metalike, por jo për akrilike dhe disa fibra modakrilike të trajtuara me ngjyrë kromi.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.8, Pika 5 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

#### 5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet llogariten siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e “d” është 1.00 me përjashtim të rastit të leshit, pambukut, fibrës bakri, fibrave modale, poliesterit, elastomultisterit, melaminës dhe poliakrilatit, për të cilat “d” = 1.01.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.9 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Leshi (1), qimet e kafshëve (2 dhe 3), mëndafshi (4), pambuku (5), fibra bakri (21), fibra modale (22), viskoza (25), akrilik (26), poliamid ose najlon (30), poliester (35), polipropilen (37), fibër qelqi (44), elastomultiester (45), melaminë (47), bikomponent polipropilen/poliamid (49) dhe poliakrilate (50).

Kur përmbajtja e leshit ose mëndafshit të përzierjes tejkalon 25 %, përdoret metoda Nr 2.

Kur përmbajtja e poliamidit ose najlonit të përzierjes tejkalon 25 %, përdoret metoda Nr 4.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.9, Pika 5 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:



## 5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet llogariten siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e “d” është 1.00; përveç melaminës dhe poliakrilatit, për të cilat “d” =1.01.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.10 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Fibra klorure të caktuara (27), përkatësisht fibrat e klorurit të polivinilit, nëse janë ose jo të kloruara, polipropileni (37), elastolefinë (46), melaminë (47). dhe fibra bikomponente polipropileni/poliamide (49), pas heqjes së lëndës jofibroze.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.11 (Titulli) ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

### MËNDAFSHI OSE POLIAMIDI DHE FIBRAT TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me përdorim të acidit sulfurik 75 % m/m)

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 1 dhe 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

#### 1. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo metodë është e aplikueshme, pas largimit të materies jo-fibrore, në përzierjet e fibrave dyfishe të:

1. Mëndafsh (4) ose poliamid ose najlon (30)



me

2. Lesh (1), qime të kafshëve (2 dhe 3), polipropilen (37), elastolefinë (46) dhe melaminë (47) dhe bikomponent polipropilen/poliamid (49).

Pika 2 (PARIMET): ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

## 2. PARIMET

Mbetja mblidhet, lahet dhe peshohet; masa e saj, nëse është e nevojshme korrigjohet, shprehet në përqindje e masës së tharë të përzierjes. Përqindja e mëndafshit të tharë gjendet nga ndryshimi.

Në masën e thatë të përzierjes me acid sulfurik me përqendrim 75% m/m, treten fibra mëndafshi, ose fibra poliamide ose najloni (\*).

Pjesa e patretur mblidhet, lahet, thahet dhe peshohet. Masa e tij, e korrigjuar sipas nevojës, shprehet si përqindje e përbërësit të patretur në raport me masën totale të fibrave në përzierje. Përqindja e mëndafshit të thatë, poliamidit ose najlonit llogaritet nga diferenca.

*(\*) Mëndafshi i egër, si mëndafshi “tussah”, nuk është plotësisht të tretshëm në acid sulfurik 75% m/m.*

Pika 4 (PROCEDURA E TESTIMIT): ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

## 4. PROCEDURA E TESTIMIT

Të zbatohet procedura e përshkruar në udhëzimet e përgjithshme dhe vazhdohet si në vijim:

Në balonën e Erlenmeyerit me vëllim të paktën 200 ml, shtoni 100 ml acid sulfurik 75% m/m për gram tub dhe më pas mbylleni me një tapë xhami. Tundeni fuqishëm dhe lëreni për 30 minuta në temperaturën e dhomës.

Tundeni sërish dhe lëreni për 30 minuta. Pas një tundje përfundimtare, përmbajtja e balonës Erlenmeyer filtrohet përmes një ene për filtrin të peshuar.



Fijet e mbetura lahen nga balona Erlenmeyer me reagent 75% të acidit sulfurik. Pjesa e patretur në enën për filtrim lahet me një sërë reagentësh prej 50 ml acid sulfurik të holluar, 50 ml ujë dhe 50 ml tretësirë të holluar të amoniakut. Pas çdo shpëlarjeje, fibrat lihen të qëndrojnë në kontakt me lëngun për rreth 10 minuta përpara se lëngu të nxirret jashtë. Në fund shpëlahet me ujë duke i lënë fijet brenda kontakt me ujin për rreth 30 minuta.

Lëngu nxirret me vakum nga ena për filtrim, filtri dhe mbetjet thahen, ftohen dhe peshohen.

Në rastin e përzierjeve me bikomponent të poliamidit me dy përbërës polipropilen/ poliamide, pas filtrimit të fibrave përmes një enë filtri të matur dhe përpara se të aplikoni procedurën e përshkruar të larjes, lani mbetjen në enën për filtrim dy herë duke përdorur çdo herë 50 ml ne acid sulfurik 75%.

Pika 5 (LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE) dhe 6 (SAKTËSIA): ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

#### 5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet llogariten siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e “d” është 1.00; përveç leshit për të cilin vlera “d”=0,985; për fibrën bikomponent polipropilen/poliamide “d” është 1.005 dhe për melaminën “d” = 1.01.

#### 6. SAKTËSIA

Për një përzierje homogjene të materialeve tekstile, kufijtë e besueshmërisë së rezultateve të marra me këtë metodë nuk janë më të mëdha se  $\pm 1$  për një nivel besueshmërie prej 95%, me përjashtim të përzierjeve dyfishe të poliamidit me bikomponent polipropilen/poliamide, për të cilat kufijtë e besueshmërisë së rezultateve nuk janë më të mëdha se  $\pm 2$ .

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.13 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:



2. Leshi (1), qimet e kafshëve (2 dhe 3), mëndafshi (4), pambuku (5), acetat (19), fibër bakri (21), fibër modale (22), triacetate (24), fije mëndafshi (25), akrilik (26), poliamid ose najlon (30), poliester (35), fibër qelqi (44), elastomultiester (45), melaminë (47) dhe poliakrilate (50).

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.13, Pika 5 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

#### 5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet llogariten siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e “d” është 1.00; përveç melaminës dhe poliakrilatit, për të cilat “d” =1.01.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.14 (Titulli) ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

#### FIBRA TË CAKTUARA DHE DISA FIBRA TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me përdorim të acidit sulfurik të përqendruar)

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. fibra të kloruruara (27), të bazuara në homopolimerë të klorurit të vinilit, nëse janë ose jo të kloruruara më pas, polipropilen (37), elastoolefinë (46), melaminë (47) dhe fibra dyshe polipropileni/poliamide (49), pas heqjes së lëndës jofibroze .

Fijet modakrilike të listuara këtu janë ato fibra që japin një tretësirë të qartë kur zhyten në acid sulfurik të përqendruar (dendësia relative 1,84 në 20°C).

Kjo metodë mund të përdoret në vend të metodës nr. 8 dhe nr. 9.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.14, Pika 2 (PARIMET): ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:





## 2. PARIMET

Përbërës tjerë përveç fibrave klorure, polipropileni, elastolefinë, melaminë ose bikomponenti polipropilen/poliamid (d.m.th. fibrat e përmendura në pikën 1 (Fusha e aplikimit): 1.) treten nga një masë e njohur e thatë e përzierjes me acid sulfurik të përqendruar (dendësia relative prej 1,84, në temperaturë 20 ° C). Mbetja e përberë nga fibrat klorure, polipropileni, elastoolefina, melamina ose fibra bikomponente polipropilen/poliamide mblidhet, lahet, thahet dhe peshohet, masa e saj, korrigjohet sipas nevojës, shprehet si përqindje e përbërësit të patretur në raport me masën totale të fibrave në përzierje. Përqindja e përbërësve të dytë fitohet nga ndryshimi.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.14, Pika 5 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

### 5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet llogariten siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e “d” është 1.00, me përjashtim të melaminës dhe fibrave bikomponente polipropilen/poliamide, për të cilat “d” = 1.01.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.15 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Leshi (1), qimet e kafshëve (2 dhe 3), mëndafshi (4), pambuku (5), fibra bakri (21), fibra modale (22), fije mëndafshi (25), poliamid ose najlon (30), akrilik (26), fibër qelqi (44), melaminë (47) dhe poliakrilate (50).

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Nëse zbulohet prania e fibrës modakrilike ose elastanit duhet kryer një provë paraprake për të përcaktuar nëse fibra është plotësisht e tretshme në reagjent.

Gjithashtu është e mundur që të analizohen përzierjet që përmbajnë fibra klorure duke përdorur metodën Nr. 9 ose 14.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.15, Pika 5 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:



## 5. LLOGARITJA DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet llogariten siç përshkruhet në udhëzimet e përgjithshme. Vlera e “d” është 1.00, me përjashtim të poliakrilatit për të cilin “d” = 1.02, për mëndafshin dhe melaminën, për të cilat “d” = 1.01 dhe akrilik, për të cilin “d” = 0,98.

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, Metoda nr.16 (Titulli) ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

### MELAMINA DHE DISA FIBRA TJERA TË CAKTUARA

(Metoda me përdorim të acidit formik)

Pika 1 (Fusha e aplikimit): 2. ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. pambuku (5), fibër aramid (31) dhe polipropileni (37).

Në Shtojcën VIII, Kapitulli 2, shtohet Metoda nr.17 me tekstin si në vijim:

### Poliestër dhe disa fibra të tjera

(Metoda duke përdorur acid trikloroacetik dhe kloroform)

1. Fusha e aplikimit

Kjo metodë është e zbatueshme, pas heqjes së lëndës jo-fibroze, në përzierjet dyshe të fibrave të:

1. poliester (35)

me

2. poliakrilat (50)

2. (Informacione te përgjithshme): plotësohet me tekstin si në vijim:

Parimi, pajisjet dhe reagenti, procedura e testimit, llogaritja dhe paraqitja e rezultateve që aplikohen për përzierjet e fibrave dyshe të poliesterit me poliakrilate janë të përshkruara në standardin EN ISO 1833-25: 2013. Vlera ‘d’ është 1,01. ‘;



## SHTOJCA IX

Ne Shtojcën IX elementet me nr. rendor 49 dhe 50 i shtohen tabelës:

Fibra Nr.	Fibrat	Përqindjet
49	Bikomponenti polypropilen/ poliamid	1,00
50	Poliakrilat	30,00'